



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-32297/23
Kaçanik, 14.12.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 20 dhjetor 2023 (e Mërkurë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të Rregullt të KPF-s të datës 20.12.2023, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Arovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K ;
3. Propozim Vendim për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024;
4. Propozim Vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024 ;
5. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-30020/23
Kaçanik, 24.11.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 nëntor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi, Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Suhad Dullovi-DBPZHR.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu- Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e X (nëntë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 24 nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;
3. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë;
4. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distribuiim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);
5. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
6. Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023.

Pika 6 është me vonesë, Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023, pasi që gjykata Kushtetuese e ka miratuar si të ligjshme faljen e tatimit në pronë. Për shkak që mos të mbajmë mbledhje të jashtëzakonshme, e kemi proceduar sot, se afati është 15 ditë dhe e procedojmë për KK. Kërkoj mendimin e juaj.

znj. Ardita Rrahmani: Duke ditur se vlerësimi i gjykatës kushtetuese ka ardhur pardje.

z. Agim Mani: Edhe unë ndaj të njëjtin mendim, ndërkaq këtë çështje ne LVV e kemi iniciuar edhe me herët, por pozita dhe disa nga opozita nuk e kanë përkrahë. Meqë jemi në fund të vitit, është dashur që falja e tatimit në pronë të jetë për vitin 2024, pasi 2023 veç po përfundon.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesa nuk ka rrjedhë nga ne, por nga deputetët e Republikës së Kosovës, që e kanë dërguar çështjen në kushtetuese dhe derisa kushtetuesja ka dhënë mendim, ne nuk kemi mundur me trajtuar këtë çështje. Atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri me një korrigjim teknik. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 25.10.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-27138/23.

2. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini, tre vendimet e mbledhjes së kaluar janë kthyer në rishqyrtim nga MAPL, ata kanë kërkuar që fillimisht pronat të shpallen me interes të përgjithshëm, e pastaj të merret vendimi për këmbimin e tyre. Dy pikë i kemi të kësaj natyre që në të ardhmen me bërë këmbim të pronave private me ato komunale. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Të gjitha pikat për shpallje me interes të përgjithshëm do të vepronin në këtë formë, apo vetëm për këto që po i trajtojmë sot dhe a kanë të drejtë aplikimi edhe pronarët tjerë privat?

Kryesuesi i Kuvendit: Deri tani janë bërë me një vendim edhe shpallja edhe këmbimi, ndërkaq për me shpallë një interes të përgjithshëm një pronë private, duhet me ekzistuar një interes i komunës për atë pronë, ato zakonisht ndodhin të projektet e rrugëve. Tani MAPL kërkon të jetë vendimi paraprak për shpallje interesi, me qëllim këmbimi.

z. Agim Mani: KK ka marrë vendim njëherë për këto pikë, janë kthyer në rishqyrtim, ato vendime kanë qenë të ndara. Tani shtohet pyetja, a ka me pasur këmbim të këtyre parcelave apo shpronësim, sepse ministria ka kërkuar të jenë me PZHK.

Kryesuesi i Kuvendit: Këto parcela, kudo që ekziston mundësia e këmbimit, të gjitha komunat e aplikojnë këmbimin e pronës, nëse nuk paraqet ndonjë problem substancial për komunën. Aty ku nuk ka mundësi me u këmbyer prona, duhet me u paguar. Këto prona i parasheh komuna me i marrë dhe i parasheh me interes publik, apo që i ka shfrytëzuar deri me tani, këto janë prona private.

z. Qamil Stagova: Interesi publik shpallet vetëm për prona private, ndërkaq ka edhe prona komunale, ligji e ka vërtetuar interesin publik për dy kategoritë e pronave.

z. Agim Mani: Në propozim vendim, të dispozitat e pikës së dytë është PK e komunës që është në pronësi të komunës. Të pika 4, paragrafi 1 dhe 2, janë dy parcela, të e para është sipërfaqja 860,5m² dhe të e dyta 2287m² në emër të Mejdi (Azem) Deda.

Kryesuesi i Kuvendit: Për pronat private në rregull, ndërkaq pronat e komunës janë me interes publik dhe nuk munden këto prona me u shfrytëzuar për diçka tjetër. Të prona e Mejdi Xhokli, fjala ka qenë për një sipërfaqe të vogël, ndërkaq Mejdi (Azem) Deda nuk ka se e di unë, kjo dallon nga propozim vendimi që e kemi pasur.

Kryetari i Komunës: Sigurisht është bërë ndonjë gabim teknik.

z. Kadri Krivenjeva: Drejtori ndoshta mundet me na sqaruar për sipërfaqen e propozuar me u shpallë interes i përgjithshëm publik.

z. Qamil Stagova: Komuna ka pasur me i marrë 41.72m² në emër të Mejdi Xhoklit në këmbim me pronën komunale. Ka të ngjarë që është krejt parcela.

Kryesuesi i Kuvendit: Këtu sipërfaqja është 2287m². Skica nuk po shihet shumë qartë. Sipërfaqja është 41.72m² me u shpallë interes në emër të Mejdi Xhokli në këmbim me sipërfaqen e njëjtë të pronës komunale. Këtu është prona me tjetër pronarë dhe numër tjetër të parcelës. Për KK drejtor me e rregulluar propozim vendimin, në skicë është mirë, ndërkaq në propozim vendim është keq. Me kërkesë që lënda për KK të përmirësohet, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik dhe Koxhaj. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë është e natyrës së njëjtë, me parcela të ndryshme në vende të ndryshme, besoj se ky propozim vendim është mirë. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë mendoj se duhet të trajtohet veç e veç secila parcelë, se nëse shkojmë si pako, ka mangësi të mëdha se nuk ka sqarime sa duhet. Fillimisht e pyes drejtorin a janë të bazuara në PZHK këto parcela me i shpallë interes publike? A e keni marrë miratimin e komunitetit, se nëse është i pajtimit komuniteti, duhet me pasur pëlqimin e tyre?

Kryesuesi i Kuvendit: Interesi publik nuk ndërlihet me PZHK, se interesi publik mund të lind në ndërkohë, ndërkaq PZHK ka afat 10 vjet. Interesin publik mund të imponon koha, si një shembje, rrëshqitje, ngushtim rruge. Të këmbimi i pronës është diçka tjetër, se nuk do të thotë që këto prona këmbehen menjëherë. Vjen propozimi tjetër me arsye të këmbimit, ndërkaq interesi publik është i arsyetuar këtu. Ka shumë prona, kjo është e njëjtë si me listën e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, këto prona ose janë rrugë ose trotuar.

z. Qamil Stagova: Deri me tani lidhur me shpalljet e pronave me interes, me qëllim të këmbimit të pronave, nuk kemi pasur asnjë rast të ankesave. Këto prona po shpallen me interes të përgjithshëm publik, ndërkaq qëllimi dihet se në të ardhmen kanë më u këmbyer me pronat komunale.

z. Agim Mani: Mos t'na ndodhë si pikat tjera të cilat janë kthyer, se vetëm njëra nga këto nuk është në rregull, kur të shkon në shqyrtim ligjor kthehet. Për këtë arsye duhet me u trajtua veç e veç, se në këtë formë kjo nuk është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit: Në rastet e interesit publik, interesi publik është i atij komuniteti ku bëhet këmbimi i pronës. Të prona e Mejdi Xhokli ka qenë e arsyeshme me u këmbyer, se e vetmja prona e tij ka qenë në rrugë, aty shihet me sesi ka devijuar rruga. Kur ka mundësi, pse mos me i shfrytëzuar të njëjtat. Në raste të jashtëzakonshme, komuna të merr pronën edhe pa të pyetur, ndërsa në këto raste kur ekziston mundësia me këmbim, me marrëveshje, është kjo mundësi që mundemi me shfrytëzuar. Krejt këto janë me pëlqimin e komunitetit, se janë interes i tyre.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pyetje për drejtorin, të parcela në rrugën Mukadeze Lika-Muhaxheri dhe një parcelë private në emër të Kumrije Tali, kësaj a i këmbëhet parcela, apo qysh çka ndodhë? Prona e Kumrije Talit është kah pjesa e Gurit të zi. A merret parasysh ndonjë marrëveshje me palën kur është në pyetje interesi publik, se në këtë rast kjo pronë po shpallet pa një marrëveshje me palën?

z. Qamil Stagova: Këto parcela nuk janë afër njëra tjetrës, njëra është të rruga “Avdyrrahim Shehu dhe tjera është në anën tjetër kah Biljantë, ndërkaq sqaroj për pjesën ku do të bëhet këmbimi i pronave. Ekziston kërkesa me herët për shpallje me interes të kësaj prone.

Kryesuesi i Kuvendit: Një pjesë e pronave i kanë edhe pëlqimet që pajtohen që prona e tyre me u shpallë me interes. Hapi i parë është që këmbimi i pronës me u bërë me marrëveshje, në rastet e domosdoshme komuna ka të drejtë me marrë pronën, e shpronëson, ndërsa çmimin ia cakton ministria.

Kryetari i Komunës: Në mbledhjen e parë, shpallet prona me interes të përgjithshëm publik, ndërkaq në mbledhjen e dytë nëse jemi pajtuar me palën për këmbim, shkojmë me procedurë të këmbimit, nëse jo shkojmë me procedurë të shpronësimit. Me herët janë bërë me një vendim, por tani është kërkuar kjo formë dhe duhet të veprojmë sipas saj.

Kryesuesi i Kuvendit: Gati se është e njëjtë me pronat që po i japim në shfrytëzim, që kërkohet me u miratuar deri me 31 dhjetor. Nëse prona nuk është në listë, nuk mundesh me e dhënë në shfrytëzim. Tani është bërë njëjtë edhe për shpallje interesi të pronave.

z. Agim Mani: Pronën mundesh me e shpallë interes të përgjithshëm publik edhe pa e pasur në listë.

Kryesuesi i Kuvendit: Me shpallë mundesh, por me i këmbyer pa i pasur të shpallura pronat me interes nuk mundesh. Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale në ZK Kaçanik, Duraj-Gabrricë, Doganaj, Sllatinë, Ivajë.

Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS);

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë ka qenë edhe më herët në KPF, në KK nuk është proceduar se drejtori kërkoj me hequr në KPF. Besoj se tani është lënda e kompletuar. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani; Këtu flitet për dhënien e pronës në shfrytëzim për 40 vjet. Nuk e di a është e ligjshme që prona të epët në shfrytëzim për 40 vite pa procedurë të ankandit publik, se bien në kundërshtim me ligjin?

z. Qamil Stagova: Prona epët në shfrytëzim për 15 vjet, në afatshkurtër, dhe taksa ka me u paguar ashtu sa është i përcaktuar çmimi për zonat rurale, ka me paguar taksa. E kemi shikuar edhe praktikën e komunave tjera, e kishin dhënë pronën për 15 vjet.

Kryesuesi i Kuvendit: Është të pika 4, afati kohor për 40 vjet.

z. Kadri Krivenjeva: Është bërë gabim teknik të afati kohor i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Kryesuesi i Kuvendit: Kur kemi të bëjmë me raste të veçanta, si është KEDS, është një kapitull në veti që i trajton këto çështje ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, caktohen tarifat dhe jepen në shfrytëzim për afatshkurtër për raste të veçanta. Kjo duhet të përmirësohet për KK, për 15 vjet dhënia në shfrytëzim.

z. Agim Mani: Qysh është kalkuluar çështja e taksave. Nëse rregullorja ndryshon, çka bëhet, se kontrata bëhet me këtë shumë, se këtu shënohet në bazë të rregullores me numër të caktuar, numri i rregullores nuk duhet të cekët në kontratë.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Tarifat janë të përcaktuara me rregulloren e taksave komunale.

Nënkryetari i komunës-Sabedin Vishi: Çështja e taksave, ceket në bazë të rregullores se taksave komunale, taksat paguhen sipas rregullores në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit: Mundet me u cekur edhe në kontratë. Kontratën e bënë ekzekutivi, pagesa e qirasë caktohet në bazë të rregullores se tarifave dhe ngarkesave, dhe kontrata duhet t'i përmbahet rregullores varësisht nga ndryshimi i saj.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Në momentin që është rregullorja në fuqi dhe palët kontraktuese nënshkruajnë marrëveshje, atëherë me atë rregullore kanë me vazhduar deri në përfundim të kontratës, kështu e jep edhe ligji.

znj. Ardita Rrahmani: Ne i kemi pasur edhe në vitin e kaluar, çështjen e kontratave të cilat nuk po mundeni me i lidhur shkakut i inflacionit, se kompanitë nuk po mundën me i realizuar, se shumica e kompanive kanë dështuar në realizim të kontratës. Qysh kanë qenë këto raste, se aty nuk ka rregullore?

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo ka ndodhë në vitin 2021. Në këto raste qeveria e Kosovës ka nxjerrë ligj që për materialet që janë ngritur çmimet në ekstrem, armatura e disa tjera. Nëse komuna e ka pasur të lidhur kontratën me komunën, është rritur vlera e kontratës për 20% mbi vlerën e kontratës. Kompanitë kanë bërë ankesë se nuk janë pajtuar me këtë vlerë të ngritjes, por ashtu kanë mbetur. Rregullore nuk ka pasur, por ligj, ligji e rrëzon rregulloren.

z. Bahri Selimi: Qeveria ka nxjerrë ligj për kompensimin e punëve publike, ashtu që me ua kompensuar kompanive shumë e mjetëve për produkte të caktuara mbi vlerën e kontratës.

z. Agim Mani: Kërkoj sqarim drejtorit të taksat komunale, të kompensimi i sipërfaqeve në emër të qirasë mujore për shfrytëzim të pronës, në ZK është caktuar 0.20m², a është për m² 20 cent. A e parashih kështu rregullorja për taksat komunale, se keni mundur me bërë kontratë se 5 vjeçare me këtë çmim. Jeni duke e dhënë në shfrytëzim pronën, pa u bazuar në rregullore, se shumica është e vogël, është dashur me bërë kontratë 5 vjeçare, se për një trafo që po vendoset, po paguan 1.80 cent, kjo nuk ka logjikë. Komuna në këtë rast humb e nuk po përfiton asgjë, veç tatimin. Interesi publik është diçka tjetër, ndërkaq kjo është korporatë- kompani dhe nuk ta falë asnjë cent.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Taksa për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale është 0.20 për m².

znj. Kadrije Lika-Troni: Modernizimi i rrjetit elektrik është obligim i kompanisë-KEDS, ndërkaq kompania nuk ua falë asnjë cent qytetarëve.

z. Qamil Stagova: Komuna përfiton modernizimin e rrjetit elektrik. Në rregulloren e tarifave dhe ngarkesave janë 4 zona, në zona rurale është çmimi me i ulët.

z. Agim Mani: Ju e keni përcaktuar njëjtë çmimin për m² në të gjitha zonat.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të llogaritja e qirasë, Rregullorja 02/2020 për taksat komunale, a mundet me u ndryshuar? Me mirë është me u ndryshuar rregullorja dhe me i paraparë këto çështje. Pse mos me përfituar komuna në këtë rast, se KEDS nuk i ofron komunës asnjë shërbim ekstra, ose me shikuar si kanë vepruar komunat tjera.

z. Qamil Stagova: Nëse i rrisim taksat, atëherë i dëmtojmë shfrytëzuesit tjerë që kanë prona komunale me qira.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe nëse ngritët taksa për 1€ m², nuk ndikon shumë në buxhet, kjo është veç me ia dhënë me një tarifë sa mos me ia dhënë falë, me iu shërbyer qytetarëve. Problemi mund të jetë edhe diku tjetër. Nëse një komunitet e ka rrjetin e dobët dhe bënë kërkesë KEDS-it për shtimin e kapacitetit të energjisë, KEDS thirret në atë që komuna nuk i ka dhënë vend për vendosje të trafos. Edhe nëse i rrisim taksat, nuk përfitojmë shumë, por duhet llogaritur përfitimet e komunitetit në këtë rast, për rritjen e kapaciteteve të fuqisë elektrike. Përfitimi i komuniteteve është i madh, se me energji të dobët nuk mund të funksionojnë makinat e amvisërisë etj. se mos me qenë interesi i qytetarëve, nuk ia vlen me diskutuar këtë çështje, se nuk janë shumë të përgjegjshëm.

z. Agim Mani: Interesi i qytetarëve është i madh, se qytetari përfiton me ndërtimin e trafos. Në këtë projekt, kemi edhe prona private, si veprohet në këtë rast?

Kryesuesi i Kuvendit: Për çështje të pronave private, nuk është e jona sesi veprojnë, çështja është se KEDS mezi pret me gjet një arsye për çështje të shërbimeve.

znj. Ardita Rrahmani: Të kontrata me Vala, a paguan nëse prona është private, vala nuk ka të bëjë asgjë me komunë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pagan qira. Nëse është prona komunale, atëherë i paguan komunës.

znj. Kadrije Lika-Troni: Qysh është e rregulluar çështja e pagesës së qirasë me Valën për pronën e komunës, a ka kontratë?

z. Bahri Selimi: Aty ku është në pronë komunale, i paguan komunës Vala në bazë të rregullores për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale. Për prona private e kanë kontratën e veçantë.

z. Agim Mani: Të pronat private bënë kontratë të veçantë Vala, ndërsa tatimet komunale nuk i paguan, se përfitimi është.

Kryesuesi i Kuvendit: Tatimin në biznes e mbledhë qeveria. Ne e mbledhim vetëm tatimin në pronë.

z. Qamil Stagova: Nëse një antenë është e regjistruar, ajo i paguan tatimin ATK.

Nënkryetari i Komunës: Aty ku janë të vendosura antenat në prona publike, i paguan komunës, ndërsa për pronën private, i paguan personit privat, në atë kontratë e paguan edhe taksën për qira.

z. Bahri Selimi: Ne i kemi edhe dhënie në shfrytëzim të pronave komunale të cilat nuk paguajnë për shkak të pandemisë, për momentin janë të liruar. Duhet me shfuqizuar atë vendim.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse në vendim është shënuar deri me përfundimin e pandemisë, pandemia ka përfunduar zyrtarisht në vitin e kaluar dhe vendimi për lirim nga qiraja ka ra nga fuqia.

z. Qamil Stagova: Shfrytëzuesit e pronës komunale janë liruar nga qiraja për vitin 2020 dhe 2021.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi për lirim të bizneseve nga taksat komunale, ai vendim e di që është shfuqizuar.

znj. Pranvera Loku-Zharku: Ata që kanë pasur objekte komunale me qira, janë liruar nga qiraja. Asnjëri vendim nuk është shfuqizuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi për lirim nga qiraja të shfrytëzuesve të pronës komunale, nuk e di, është dashur me u shfuqizuar ai vendim. Ai vendim është dashur të shfuqizohet me automatizëm me përfundimin e pandemisë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me kohë të caktuar për raste të veçanta, kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. a (KEDS). Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin;

znj. Ardita Rrahmani: Nëse debatojmë, nuk do të thotë se ndryshojmë diçka, kështu që e diskutojmë në KK këtë raport.

z. Agim Mani: Në raport janë paraparë dy rreziqe: 1. Në fushën specifike të rrezikut dhe 2. Në fushat e përgjithshme të rrezikut. Pasi drejtoresha nuk është këtu, e diskutojmë në KK.

Nënkryetari i Komunës: Kjo çështje bien në kuadër të DAP, raportin e ka hartuar komisioni, ndërkaq është në obligim ligjor që kërkohet nga komunat për shkak të performancës. Ligji ka ndryshuar me inicim të qeverisë dhe kërkohet që komisioni me bërë planin për 4 vjet 2024-2028. Ky është një raport ku janë paraparë se ku ka rreziqe më tepër, si të DUKMM, Zyra e Kryetarit, ku janë dhënë sugjerimet nga komisioni për rreziqet që mund të ndodhin.

z. Agim Mani: Pyetjen që desha me bërë unë, lidhur me rreziqet, cilat janë vlerësimet e rrezikut dhe masat parandaluese për evitimin e tyre?

Nënkryetari i Komunës: Të masat parandaluese, raporti është për vitin 2022, ndërkaq komisioni të sqaron që të prokurimi, auditimi i brendshëm, urbanizmi etj. me shikuar se ku mund të ndodhin rreziqe. Është raporti i auditimit të jashtëm, nëse të vjen raporti negativ, çka mundet me marrë komuna për eliminimin e rreziqeve për me përfutur mjete financiare. Të prokurimi publik, nëse është neglizhenca të prokurimi publik, atëherë mundet me të dështuar kontrata, ose fjala vjen nëse është të OSHP siç ishte me projektin e rrugës në Stagovë, raporti t'i tregon ngecjet.

z. Agim Mani: Gjatë vlerësimit, janë evidentuar rreziqet, mirëpo cilat janë masat parandaluese që këto mos me ndodhë?

Nënkryetari i Komunës: Në raport na kanë paralajmëruar se ku munden me ndodhur rreziqet. Për momentin, raporti i auditimit është i pa kualifikuar, më i miri i mundur dhe nuk ka pasur nevojë për veprime parandaluese.

Kryesuesi i Kuvendit: Me qenë drejtoresha na kishte sqaruar me mirë. Të konflikti i interesit, këtë e paraqet ligji si definicion, ndërkaq në raport është dashur me u cekur se në sa raste komuna është përballë me konflikt të interesit.

Nënkryetari i Komunës: Ndonjë konflikt konkret të interesit nuk ka pasur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që t'i shkoj KK për diskutim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Diskutoj Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2022. Ky raport i dërgohet Kuvendit të Komunës në procedurë për diskutim.

10. Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi Diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Ne si LDK e kemi një qëndrim, kjo është si pasojë e qëndrimit të LDK.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne si komunë na dëmton të HVK sidomos neve komunat e vogla, na dëmton për 300-400 mijë euro. E rrugës është që qeveria me i rimburësuar këto mjete.

z. Bahri Selimi: Vendimi i jonë dhe i LDK ka qenë për mos me u realizuar ky vendim, por tani po detyrohem.

znj. Kadrije Lika-Troni: Disa komuna kanë marrë vendim me herët me ua falë qytetarëve tatimin në pronë.

Kryesuesi i Kuvendit: Të HVK na dëmtohen, por është ligj dhe duhet me zbatuar. Falja është bërë pa përjashtim edhe atyre që kanë, se për ata që nuk kanë mundësi kishte me qenë në rregull.

z. Bahri Selimi: Falja e tatimit në pronë për vitin 2023 është deri 100€.

Kryesuesi i Kuvendit: Komunat të cilat kanë vendosur me herët, ua ka kthyer MAPL se nuk ka pasur ligj atëherë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë, për vitin tatimor 2023. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj të di çka u bë me vizitën studimore të cilën e kemi pasur me realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me vizitën studimore, iu njoftoj se është një ankesë në OSHP.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 30.11.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna Kaçanik

Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik



KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË
PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

DATË/A:	04.12.2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kuvendi Komunal Kaçanik
NGA/OD/FROM:	Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	AKTPËRCJELLËS për procedim të lëndës në procedurat e Kuvendit për votim

Bazuar në nenit, 19 pika 3, 4, 5 të Ligjit nr.06/l-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, nenit 21 pika 6 të rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, në afatin ligjor, si dhe në pajtim me ligjit dhe rregulloren për procedura të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës. dhe pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës e procedon në Kuvendin e Komunës për aprovim ofertën e përzgjedhur si me poshtë:

- Në Parcela Kadastrale nr. **P-70917093-00156-7**, me kulturë Kullosë e klasës 3 dhe 4 në sipërfaqe prej 00.55.00 ha që gjendet në Zonën kadastrale Koxhaj, me pronar Komuna e Kaçanikut, të destinuara për Zhvillim Ekonomik

Emri i Ofertuesit (Fizik apo Juridik)	Nr. I protokollit dhe data
ERA PLAST – SHPK	01/104/02-0029458/23; 13.11.2023
Përshkrimi i Biznesit: <i>Aktiviteti i biznesit ka të bëjë me ndërtimin e objekteve dhe furnizimin e makinerisë për prodhimin e plastmasave të ndryshme të cilat përdoren në shumë industri dhe produkte të ndryshme, kompania Era Plast do të prodhojë një gamë të gjerë të produkteve të plastikës, jo vetëm për konsumator por edhe për prodhuesit, këto produkte plastike mund të konsumohen direkt nga konsumatorët për transportin e ujit dhe gjësëndeve të ndryshme etj. kompania do të prodhojë edhe kova, arka të plastikës për bizneset që prodhojnë ujë të Filtruar, lëngje dhe pije jo alkoolike, dhe gjithashtu do të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat e kompanive të lidhura me kimikate. Nr. i të punësuarave 50 (ku 60% do të jenë Femra), sipërfaqja e kërkuar në dy parcelat 00.55.00 Ha.</i>	Vlera e investimit Euro (1,200.000.00€)

Me këtë akt përcjellës i dorëzon komplet shkresat origjinale të lëndës ë renditur si më poshtë


- Një kopje të shpalljes së njoftimit për shprehje të interesit;
- Procesverbalin e hapjes së ofertave dhe raportin për vlerësimin e ofertave;
- Rekomandimin e Komisionit për përzgjedhjen e fituesit;
- Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur;

Kaçanik

04.12.2023

Kryetari I Komisionit Vlerësues

Besmir Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik - Municipality Kaçanik



01Nr. 104/02-30266/23
Datë 20.11.2023

KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 17, 19 dhe 20 të Ligjit nr.06/I-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, neneve 19, 20 dhe 21 të rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, vendimi për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023, numri i protokollit 01.NR.104/02-32812/22 të datës 29.12.2022, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13790/2023, të datës 30.06.2023 dhe i plotësimit ndryshimin e vendimit paraparak 01.NR.104.02-18514/2023, të datës 31.07.2023 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13788/2023, të datës 30.06.2023, i plotësuar dhe i ndryshuar me vendimit 01.NR.104/02-18517/2023, të datës 31.07.2023 në Zonat Katastrale Doganaj, Koxhaj dhe Bagacë, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, shpallë këtë:

NJOFTIM PËRFUNDIMTAR

Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të ankandit publik - shprehjes së interesit të shpallur më datë 27.10.2023 me Nr.01-060/05-28025/23 dhe të mbyllur më datë 13.11.2023 Komisioni Vlerësues i Ofertave për dhënien e Pronës së Paluajtshme në Shfrytëzim të Komunës njofton këtë:

REKOMANDIM

I. Parcela Kadastrale nr. P-70917093-00156-7 në kulturë Kullosë e klasës 4, sipërfaqja prej 00.55.00 ha e cila do të ipej në shfrytëzim afatgjatë e cila gjendet në Zonën kadastrale – Koxhaj, me pronar Komuna e Kaçanikut, të destinuara për Zhvillim Ekonomik, sipas komisionit vlerësues përzgjidhet oferta Ekonomikisht më të favorshme:

II. ERA PLAST – SHPK, me nr. të protokollit 01/104/02-0029458/23 të datës 13.11.2023.

Palët e pakënaqur nga procesi i vlerësimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit (Shpallja në Web – faqe zyrtare) ka të drejtë të paraqes ankesë brenda shtatë (7) dite kalendarike në Komisionin e ankesave për procedura të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Me këtë Njoftim Përfundimtar njoftohen: Kuvendi Komunal Kaçanik, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe Arkivi.

Kaçanik

Datë 20.11.2023

Komisioni Vlerësues

1. Besmir Krasniqi (Anëtar);
2. Aronora Kuka (Anëtare);
3. Bashkim Krasniqi (Anëtar);
4. Bashkim Luma (Anëtar);
5. Reni Reka (Anëtar).





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna Kaçanik

Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik



01 Nr. 104/02-28025/23

Datë 27.10.2023

Në mbështetje të nenit 8 pika 1.2, nenit 13, 14 dhe nenit 15 të ligjit nr.06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 prill 2019, neneve 13, 14, 15, 19 dhe 20 të rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, vendimi për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023, numri i protokollit 01.NR.104/02-32812/2022 të datës 29.12.2022, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13790/2023, të datës 30.06.2023 dhe i plotësim ndryshimit të vendimit paraprak 01.NR.104/02-18514/2023, të datës 31.07.2023 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13788/2023, të datës 30.06.2023, i plotësuar dhe i ndryshuar me vendimin 01.NR.104/02-18517/2023, të datës 31.07.2023 në Zonat Katastrale Doganaj, Koxhaj dhe Begracë Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, shpallë këtë :

NJOFTIM PUBLIK - SHPREHJES SË INTERESIT

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME

TË KOMUNËS PËR 99 VITE

Komuna e Kaçanikut në pajtim me Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13790/2023, të datës 30.06.2023 dhe i plotësim ndryshimit të vendimit paraprak 01.NR.104/02-18514/2023, të datës 31.07.2023 dhe Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13788/2023, të datës 30.06.2023, i plotësuar dhe i ndryshuar me vendimin 01.NR.104/02-18517/2023, të datës 31.07.2023 në Zonat Katastrale Doganaj, Koxhaj dhe Begracë, jep në shfrytëzim afatgjatë (99 vite) pronat e paluajtshme me shënimet në tabelën si më poshtë:

N r.	Emir i Pronarit të Parcelës	Nr. i parcelës Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqja në shfrytëzim, ha	Kategorizimi i pronës, (Kultura)
1.	Komuna e Kaçanikut	P-70917026-00143-2	Doganaj	01.50.01 ha	Kullosë e klasës 4
2.	Komuna e Kaçanikut	P-70917026-00143-4	Doganaj	01.00.00 ha	Kullosë e klasës 4
3.	Komuna e Kaçanikut	P-70917026-00143-5	Doganaj	00.87.77 ha	Kullosë e klasës 4
4.	Komuna e Kaçanikut	P-70917093-00156-5	Koxhaj	00.50.10 ha	Kullosë e klasës 4
5.	Komuna e Kaçanikut	P-70917093-00156-7	Koxhaj	00.55.00 ha	Kullosë e klasës 3 dhe 4
6.	Komuna e Kaçanikut	P-70917093-00156-8	Koxhaj	00.55.00 ha	Kullosë e klasës 3
7.	Komuna e Kaçanikut	P-70917003-02706-3	Begracë	02.09.05 ha	Kullosë e klasës 3
8.	Komuna e Kaçanikut	P-70917003-02706-5	Begracë	00.61.42 ha	Kullosë e klasës 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të cekura më lartë është krijimi i hapësirës për investitorët serioz për investim në biznese prodhuese- përpunuese, apo të ngjashëm. sipas standardëve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTAVE

Zgjedhja e ofertave më të favorshme për Komunën për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:

1. Vlera e investimit;
2. Numri i të punësuarve nga investimi;
3. Lloji i investimit që konsiderohet më interes dhe prioritet për komunën;
4. Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;
5. Qarkullimi bankar për 3 vitet e fundit;
6. Vërtetimi i tatimit në pronë.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PJESËMARRËSVE NË SHPREHJEN E INTERESIT

Personat fizik dhe juridik kane te drejte te paraqesin ofertat e tyre për marrjen e pronës se komunës ne shfrytëzim afatgjate

PJESMARRSIT NE KËTË PROCES KANË TË DREJTË:

- Të Informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit;
 - Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
 - Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës;
 - Te tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave
-
- Pronat të cilat janë objekt i këtij njoftimi publik nuk mund të përdoren për qëllime tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik. Të njëjtat nuk mund të barten në personin e tretë ose të jepen me qira.
 - Pjesëmarrësve në konkurrim i 'u garantohet e drejta që të: informohen lidhur me procedurat e shprehjes së interesit; vizitojnë (shohin) pronat që do të jepen në shfrytëzim me dt. 30.10.2023 deri me datën 13.11.2023, çdo ditë pune nga ora 10:00 -12:00 h.

OFERTA DUHET TE PERMBAJNË

Shënimet e ofertuesit, numrin e këtij Njoftimi publik, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi pronën për të cilën ofertohej, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik duhet të nënshkruhet dhe vuloget nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën – parcelën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale të ofertuar. Kuverta në faqen e parë duhet të përmbajë shënimin:

KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NE SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SE KAÇANIKUT

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë, sporteli Nr.8 në formën fizike dhe në formë elektronike nga web faqja e Komunës.

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënie e pronave për shfrytëzim afatgjatë përmes shprehjes së interesit është pesëmbëdhjete (15) ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Komunës, në vendet publike dhe në media lokale, elektronike të shkruara dhe në vendin ku gjendet prona e komunës e cila jepet në shfrytëzim .

Aplikacioni bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur për secilën parcelë kadastrale dorëzohet në ndërtesën e Komunës kati I-rë në Qendrën për Shërbime për Qytetarë sporteli nr. 8, në afat prej 15 ditësh kalendarike nga dita e publikimit të këtij Njoftimi.

Afati për aplikim: 30/10/2023 - 13/11/2023

Ofertat të pakompletuara, të pa precizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.

VENDI, KOHA KU DO TË MBAHET NJOFTIM PUBLIK - SHPREHJES SË INTERESIT

:

Në sallën e Kuvendit Komunal Kaçanik me datë **14.11.2023**, me fillim nga ora **13:00 h** , do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në Njoftimin publik.

Gjatë hapjes së ofertave marrin pjesë nënshkruesit e ofertave, përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do t'i dërgohet fituesit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe do të publikohet në Web faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtese mund të merren në Ndërtesën e Komunës, kati i -I-rë, zyrat Nr. 01 dhe 02 Sektori i tatimit ne prone , Shërbimeve Kadastrale nr. 10, si dhe anëtarët e komisionit vlerësues.

Besmir Krasniqi, Tel; +383 49 460 122, Email besmir.krasniqi@rks-gov.net

Arbnora Kuka Tel; +383 45 500 441, Email arbnora.sallahu@rks-gov.net

Bashkim Krasniqi Tel; +383 44 225 439, Email bashkim.h.krasniqi@rks-gov.net

Bashkim Luma Tel; +383 43 510 782, Email bashkim.luma@rks-gov.net

Remzi Reka Tel; +383 45 537 873, Email remzisreka@gmail.com

Kaçanik

Datë 27.10.2023

Komisioni vlerësues

1. Besmir Krasniqi (Kryetar); Besmir Krasniqi
2. Arbnora Kuka (Anëtare); Arbnora Kuka
3. Bashkim Krasniqi (Anëtar); Bashkim Krasniqi
4. Bashkim Luma (Anëtar); Bashkim Luma
5. Remzi Reka (Anëtar); Remzi Reka





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Kaçanikut

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

DUKMM-27986/2023

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

27.10.2023 - 09:28

Komuna / Opština / Municipality:

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK
KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licent broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Državu državljanstva ili uknjiženja Country citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Kaçanikut			/	600246913	KOSOVA/ KOSOVA/ KOSOVO		28.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
/		QAMII, ILAZI		



Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br. Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna Kultura-klasa use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917003-02706-3	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	Begracë / Begracë / Begracë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		TREN MALA FUSHA MOLLE TREN MALA FUSHA MOLLE TREN MALA FUSHA MOLLE	20905	Bujësiore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 3 Klase / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavna / Single possessor	25.09.2019
P-70917003-02706-5	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	Begracë / Begracë / Begracë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		TREN MALA FUSHA MOLLE TREN MALA FUSHA MOLLE TREN MALA FUSHA MOLLE	6142	Bujësiore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 3 Klase / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavna / Single possessor	25.09.2019
P-70917026-00143-2	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	Doganaj / Doganovic / Doganaj	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA MULES / FUSHA MULES / FUSHA MULES	15001	Bujësiore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 4 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavna / Single possessor	09.06.2020
P-70917026-00143-4	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	Doganaj / Doganovic / Doganaj	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA MULES / FUSHA MULES / FUSHA MULES	10000	Bujësiore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 4 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavna / Single possessor	07.06.2023
P-70917026-00143-5	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK	Doganaj / Doganovic / Doganaj	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA MULES / FUSHA MULES / FUSHA MULES	8777	Bujësiore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 4 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drazavna / Single possessor	07.06.2023

P-70917093-00156-5	KACANIK / KACANIK / KACANIK	Koxhai / Koxhai / Koxhai	PARCELE / PARCELA / parcel	Prone shoqerore Društvena Imovina Socially owned Land / R	MERAJA / MERAJA / MERAJA	5010	Bujësore - Kullosat - Kullosë I: Klases 4 / Poljoprvredho - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	28.03.2023
P-70917093-00156-7	KACANIK / KACANIK / KACANIK	Koxhai / Koxhai / Koxhai	PARCELE / PARCELA / parcel	Prone shoqerore Društvena Imovina Socially owned Land / R	MERAJA / MERAJA / MERAJA	5500	Bujësore - Kullosat - Kullosë I: Klases 4 / Bujësore - Kullosat - Kullosë I: Klases 3 / Poljoprvredho - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / Poljoprvredho - Pashnjaci - Pashnjak 3 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	06.06.2023
P-70917093-00156-8	KACANIK / KACANIK / KACANIK	Koxhai / Koxhai / Koxhai	PARCELE / PARCELA / parcel	Prone shoqerore Društvena Imovina Socially owned Land / R	MERAJA / MERAJA / MERAJA	5500	Bujësore - Kullosat - Kullosë I: Klases 3 / Poljoprvredho - Pashnjaci - Pashnjak 3 Klase / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	06.06.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Doganaj

27 9861 2023

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917026-00143-2	Parcelë / Parcela / Parcel	15001
P-70917026-00143-4	Parcelë / Parcela / Parcel	10000
P-70917026-00143-5	Parcelë / Parcela / Parcel	8777



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2910

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 27.10.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:17:33

Nënshkrimi/Potpis/S gnature:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Koxhaj

27.10.2023

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917093-00156-5	Parcelë / Parcela / Parcel	5010
P-70917093-00156-7	Parcelë / Parcela / Parcel	5500
P-70917093-00156-8	Parcelë / Parcela / Parcel	5500



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2040

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 27.10.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:19:51

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovvoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Begracë

27586/2023

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917003-02706-5	Parcelë / Parcela / Parcel	6142
P-70917003-02706-3	Parcelë / Parcela / Parcel	20905



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2095

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 27.10.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:20:38


Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Zk Dogana j





ZK Begradce





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna Kaçanik

Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik



KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 21 pika 2 të rregullores (QRK) nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të datës 10 gusht 2020, Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 01.NR.104/02-13788/2023, të datës 30.06.2023, i plotësuar dhe i ndryshuar me vendimit 01.NR.104/02-18517/2023, të datës 31.07.2023 në Zonat Katastrale Doganaj, Koxhaj dhe Begracë Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Kaçanikut hap këtë

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Në mbledhjen morën pjesë:

1. Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Besmir Krasniqi, Arbnora Kuka, Bashkim Krasniqi, Bashkim Luma dhe Remzi Reka.

Munguan:

2. Aplikuesit – përfaqësuesit të ofertave që marrin pjesë nënshkruarit e ofertave, përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Përfaqësues – Pronari Ilir Runjeva

Munguan:

Përfaqësuesi i kompanisë COMPANY MURSEL SHPK

Mbledhjen e udhëhoqi:

Kryesuesi i Komisionit Besmir Krasniqi.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite 1.

HAPJA E OFERTAVE LIDHUR ME NJOFTIM PUBLIK - SHPREHJES SË INTERESIT
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I mbajtur më datën 14.11.2023, në ora 13:00 në sallën e Kuvendit Komunal Kaçanik,

Kryetari i Komisionit Besmir Krasniqi, bënë hapjen e mbledhjes,

